

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	03-4012/12
Data Datum Date	06.11.2012

Nr. regj. 24904/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Engin Beyoglu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të Lartë Publik nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73.73.195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 16.10. 2012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Engin Hamdi Beyoglu, i lindur më 21.07.1971 në Prishtinë, ku edhe tani jeton në Rr. Bajram Kelmendi nr. nr. 37, i martuar baba i dy fëmijëve, Zëvendës kryesues i Kuvendit në Komunën e Prishtinës, me shkollim superior, i gjendjes së mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Është përgjegjës

Sepse me si Zyrtar i lartë Publik, në Pozitë Zëvendës kryesues i Kuvendit në Komunën e Prishtinës, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 paragraf 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike**, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

DENIMI

Me gjobë në shumë prej **1500 (njëmijepesëqind)** Euro. Gjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Paga bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po që se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njejta do të zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njejtë sikurse gjobën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr. 01 3205 të dt. 15.07.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të shënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili ka pranuar tërësisht fajësinë se nuk e ka deklaruar pasurinë dhe këtë mosveprim e arsyeton se nuk ka qene ne dijeni se është i obliguar për çdo vit ta deklaroj pasurinë. Me tej në deklaratën e tij e pranon se edhe në vitin pasi në vitin 2011 nga po ka gjykate është dënuar për të njëjtën kundërvajtje. Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin i deklaratës se të pandehurit, ushtruesit të Kërkesës të Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe baze të dhënave të parashtruara në kërkesë, shqimit të shkresave të lendes dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është dënuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kurse mbrojtjen e të pandehurit e hudhi si të pa bazë.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK andaj të LMK-ës të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit të i

03-4012/02/04
gug

pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksa.